



**Organisation for Security and Co-operation in Europe
Presence in Albania**

**Raporti në Këshillin e Përhershëm
Ambasadori Osmo Lipponen, Kryetari i Prezencës
5 qershor 2003**

Hyrje

Që nga raporti i fundit i Prezencës i mbajtur në Këshillin e Përhershëm më 6 shkurt, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri ka vazhduar procesin e ridimensionimit të punës së saj, duke përfunduar strukturimin e ri të saj dhe duke u përqendruar më shumë në çështjet kyçe. Përmes këtij procesi, Prezenca e ka ripozicionuar veten në qendër të debatit në rolin e moderatorit dhe lehtësuesit për çështje të rëndësishme politike që po përballon vendi, si reforma zgjedhore dhe kthimi i pronave. Duke pasur parasysh rolin e Prezencës si lehtësuese e proceseve politike dhe nivelin e saj të lartë të ekspertizës, ajo po plotëson më së miri punën e Komisionit Evropian duke mos konkurruar me rolin e tij në rritje në kryesimin e Procesit të Stabilizim Asociimit dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë në vend të përfshirë në procesin e reformave.

Klima e përgjithshme politike në Shqipëri ka vazhduar të influencohet nga fryma e konsensusit, megjithëse marrëdhëniet ndërpartiake janë bërë shumë më konkurruese për shkak të fillimit të fushatës së zgjedhjeve të ardhshme të pushtetit vendor të tetorit. Duke pasur parasysh të ardhmen e paqartë të zgjedhjeve të pushtetit vendor, i është kushtuar më shumë vëmendje Komisionit Dypalësh për Zbatimin e Rekomandimeve të ODIHR-it dhe përfundimin e procesit të reformës zgjedhore, në të cilin Prezenca ka luajtur një rol qëndror. Çështja tjetër kryesore e reformës mbi pronësinë e tokës ka marrë një karakter më politik edhe si pasojë e presioneve të zgjedhjeve.

Duke pasur parasysh shqetësimin aktual të politikës shqiptare në lidhje me çështjet që direkt apo indirekt kanë të bëjnë me zgjedhjet e ardhshme, ky raport do të përqendrohet kryesisht në këto çështje, në atë se si po ndodhin ndryshimet aktualisht në sferën politike dhe se si ka ndikuar puna e Prezencës dhe roli i saj në lehtësimin e dialogut. Këtu është shprehur shqetësim përse i përket debatit të kohëve të fundit mbi lirinë e medias, që mund të ketë pasojë afatgjatë, i cili duket se ka lidhje me fushatën zgjedhore, tani që partitë u janë dhënë shanse të barabarta nga Kodi Zgjedhor i përmirësuar. Në këtë raport, vihet në dukje, gjithashtu, edhe politika rajonale e Shqipërisë dhe realizimi i nënshkrimit të Kartës së Adriatikut, pasi ato tregojnë se si mund të arrihet suksesi duke vendosur prioritete dhe duke u përqendruar në to.

Konteksti i Përgjithshëm

Raporti i Prezencës i mbajtur në muajin shkurt në Këshillin e Përhershëm tregoi se pakti konsensual midis z.Nano dhe Dr.Berishës u prish si pasojë e presioneve në rritje të fushatës parazgjedhore. Megjithatë, është e qartë se gjashtë muajt e “periudhës së konsensusit”,

shërbyen si një interval i nevojshëm dhe, së bashku me ndikimin pozitiv të Komisionit Dypalësh, sollën një ndryshim kulturor premtues në mënyrën se si po zhvillohet tashmë politika. Vetë termi “konsensus” është bërë tashmë pjesë e pandashme e fjalorit të politikanëve dhe rrugët e komunikimit janë hapur në nivele të ndryshme mes strukturave të partive. Duke pasur parasysh se Kuvendi është arena kryesore ku opozita është pjesëmarrëse në procesin e hartimit të politikave, veprimtaria politike dhe ligjvënëse ka marrë një rëndësi të veçantë. Si pasojë, Kuvendi është bërë fokusi kryesor i vëmendjes, duke u pasqyruar rregullisht dhe gjerësisht në media. Projekti i Prezencës në mbështetje të Kuvendit ka mundur që të çojë më tej përpjekjet e deputetëve për të rritur rolin dhe përgjegjësitë e tyre, duke dhënë rezultate pozitive që i kalojnë parashikimet fillestare të projektit.

Kthimi në politikën “tradicionale” shqipëtare, siç u tregua edhe nga retorikat e zjarra të përdorura gjatë debateve të periudhës shkurt-prill mbi ngritjen e komisionit hetimor për aktivitetet e Bashkisë së Tiranës dhe Ministrisë së Kulturës–kryesisht për qëllimet e opozitës për të ndjekur pretendimet e tyre kundër Kryetarit aktual të Bashkisë së Tiranës, Edi Rama, është rezultat i afrimit të zgjedhjeve dhe nevojës së politikanëve për të fituar pikë nga elektorati i tyre tradicional. Këto zhvillime pasqyrojnë një dinamizëm në rritje të zhvillimeve demokratike në vend dhe jo shenja të paqëndrueshmërisë politike. Nga ky këndvështrim, sulmet e zjarra të Dr Berishës dhe taktikat obstruksioniste të përdorura nga figura të tjera të opozitës në Kuvend përfaqësojnë mjete të ngjashme të ushtrimit të presionit politik, në mos disi më pak të zhvilluara, me ato që shihen në demokraci më të përparuara perëndimore.

Deklarimet e opozitës për të përdorur të gjitha mjetet që u ofron atyre rregullorja e brendshme e Kuvendit për të bllokuar interesat e shumicës, tregojnë një angazhim të opozitës në procesin politik dhe jo refuzim, siç ka bërë ajo më parë përmes bojkotimit. Për më tepër, deklaratimet e tyre të mëtejshme se manovrimet lidhur me çështjen e komisionit hetimor kishin për qëllim mbrojtjen e Kushtetutës, janë, gjithashtu, të rëndësishme, pasi ata, në fillim, e kishin bojkotuar referendumin për Kushtetutën në vitin 1998 dhe kishin refuzuar ta njihnin autoritetin e saj, sapo ajo u miratua. Prandaj, veprimet e opozitës gjatë muajve të fundit duket se tregojnë një ndryshim, veçanërisht, në qëndrimin e Partisë Demokratike drejt angazhimit të plotë në procesin politik për të mos i lënë mundësi maxhorancës të vendosë arbitrarisht mbi çështje të ndryshme.

Megjithëse akoma përdoren akuza dhe retorika për të kënaqur mbështetësit e partisë në bazë, vihet re një pjekuri e udhëheqësve kryesorë politikë, e cila mund t’i atribuohet kryesisht rezultateve të punës konstruktive dhe konsensuale të Komisionit Dypalësh dhe Procesit të Stabilizim Asociimit. Procesi i Stabilizim Asociimit ka dëshmuar se është një forcë ndikuese që kërkon ndryshime në nivelin teknik dhe legjislativ, por që ka filluar, gjithashtu, të nxisë modernizimin e qëndrimeve politike shqiptare. Edhe mbështetja që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë procesit të Stabilizim Asociimit dhe objektivave të këtij procesi ka pasur një ndikim të konsiderueshëm.

Rezoluta e Kuvendit mbi Raportin e Dytë Vjetor të Komisionit Evropian mbi Procesin e Stabilizim Asociimit në Shqipëri¹ ilustron shembullin e mësipërm. Debatit i zgjatur dyditor mbi këtë raport u provokua nga një mocion i opozitës ku i kërkohej Kryeministrit Nano të shpjegonte arsyet për tonin shumë kritik të raportit. Në mënyrë që të mos humbisnin përfundimet kryesore të debatit, Komisioni i Punëve të Jashtme hartoi një rezolutë, në të cilën Kuvendi i kërkonte Qeverisë të ndërmerre një numër veprimesh të rëndësishme në përgjigje të raportit të Komisionit. Këto veprime përfshinin përgatitjen e një Strategjie Kombëtare për Integrimin në Bashkimin Evropian, përqëndrimin në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit dhe paraqitjen e një plani veprimi për përsheptimin e reformës së ndërmarrjeve strategjike. Kuvendi deklaroi, gjithashtu, mbështetjen e tij për përpjekjet e Presidentit në lidhje me reformën gjyqësore dhe i bëri thirrje partive politike për të forcuar frymën e dialogut dhe për të garantuar stabilitet politik.

Elementët e rezolutës janë të ngjashëm me deklaratat e mëparshme të Grupit të Miqve të Shqipërisë, që tregon se institucionet shtetërore e kuptojnë dhe kanë filluar të përmbushin rolin e tyre kushtetues të ekuilibrit të pushtetit të Qeverisë, duke vepruar si mekanizma mbikqyrës. Mënyra se si Kuvendi siguron që Qeveria të veprojë në përputhje me rezolutën do të jetë një shenjë e rëndësishme e vazhdimësisë së vullnetit të përbashkët politik për ta çuar vendin përpara në procesin e Stabilizim Asociimit.

Pavarësisht nga tendencat pozitive që duken në strukturat politike kryesore dhe marrëdhëniet institucionale, zbatimi i ligjeve dhe një proces reformash vazhdimisht të copëtuara ende e pengon zhvillimin e Shqipërisë. Siç theksohet edhe në raportin e Komisionit Evropian për Procesin e Stabilizim Asociimit, “stabiliteti politik relativ dhe dialogu i rinisur ndërpartiak ...akoma nuk mund të quhet një arritje e rëndësishme për sa i përket aspektit të reformave.” Toni kritik i këtij raporti duket se ka nxitur Qeverinë dhe Kuvendin të bëjnë më shumë përpjekje. Megjithatë, vështirësia kryesore në realizimin e një programi ambicioz të reformave të kërkuara që synojnë përmirësimin e qeverisjes dhe luftën kundër korrupsionit vjen nga rezistenca e brendshme që lind nga interesat ekonomike ekzistuese që preferojnë të vazhdojnë të marrin përfitime private, në kurriz të mirëqënies sociale të përgjithshme.²

Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto në vitin 2002 u ul në 4,7%³, pasi kishte qëndruar mesatarisht në nivelin 7-8% për vite me radhë. Kjo mund t'i atribuohet një sërë faktorësh që kanë lidhje me paqëndrueshmërinë politike të vitit të kaluar, krizës së vazhdueshme të energjisë, përmbytjeve të vjeshtës së kaluar, mungesës së likuiditetit në sistemin bankar për të financuar deficitin e shtetit dhe shtytjes së privatizimeve kyçe të Albtelekomit dhe Bankës Kombëtare të Kursimeve, që është, gjithashtu, një tregues i zvogëlimit të investimeve të huaja në vend. Pas një rritjeje të inflacionit në 5,4% në vitin 2002⁴, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë ka paralajmëruar së fundi për një rritje të re të

¹ Komisioni Evropian, *Raport mbi Stabilizimin dhe Asociimin e Shqipërisë 2003*, SEC (2003) 339, (Bruksel, 26 mars 2003).

² Fondi Monetar Ndërkombëtar. *Shqipëria: Çështje të Përzgjedhura dhe Statistika*. Raporti mbi Vendin No. 03/64 (Washington, DC: mars 2003):25-26.

³ Banka e Shqipërisë, *Raporti Vjetor për 2002* (Tiranë, 31. 03. 2003)

⁴ Po aty, v.

inflacionit, si rezultat i shpenzimeve publike të paplanifikuara për shkak të fushatës zgjedhore.

Shkalla më e ulët e rritjes ekonomike shkaktoi një rishikim të paplanifikuar të buxhetit afatmesëm vitin e kaluar dhe çoi në një ulje të shpenzimeve buxhetore për vitin 2003. Për këtë arsye, rritja e të ardhurave të shtetit ka qënë përparësi, pasi doganat dhe mbledhja e taksave arritën mbi 90% të objektivave të planifikuara⁵. Megjithëse mbledhja e taksave është rritur vazhdimisht gjatë viteve, FMN-ja ka vënë re se sistemi karakterizohet ende nga “kontrabanda e vazhdueshme, raportimi më i ulët në fatura, falsifikimi i bilanceve dhe një dobësi e përgjithshme në zbatimin e ligjit (për taksat)”⁶. Pretendimet për favorizim shfaqur ndaj disa kompanive me lidhje të forta dhe vënia në shënjestër e firmave të huaja nuk kanë ndihmuar shumë në rritjen e besimit të investuesve në vend. Sulmet e kohëve të fundit ndaj disa biznesmenëve të njohur ka shkaktuar tension në komunitetin e biznesmenëve, të cilët ndihen të kërcënuar mes treguesve ekonomikë në ulje dhe konkurrencës në rritje.

Një rrymë e fshehtë ballafaquese është ende e fortë dhe vazhdon të ketë tendenca shpërthyesë në shoqërinë shqiptare. Demonstratat e kohëve të fundit ishin shumë afër daljes nga kontrolli i forcave të policisë dhe përhapjes në zona të tjera, duke treguar se mënyra e vjetër e daljes në rrugë për të kërkuar zgjidhje ekziston ende. Pronat dhe çështje të tjera të kompensimit po zhgënjajnë shumë njerëz dhe realiteti shoqëror e ekonomik është i zymtë për pjesën më të madhe të popullsisë.

Shfaqja së fundmi e fushatës së gjerë MJAFIT!, që ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të opinionit publik dhe nxitjen e angazhimit qytetar në lidhje me çështje të cilësisë së jetës dhe qeverisjes, përfaqëson një përpjekje për të krijuar një zë kritik ndaj statukuosë. Përfshirja e shpejtë e fushatës MJAFIT! në kulturën popullore gjatë tre muajve të fundit tregon se temat e tyre i kanë gjetur telat një pjese të shoqërisë të pakënaqur me natyrën pasive dhe të izoluar të politikës në vend. Ndërsa zhvillimet pozitive politike të vërejtura më sipër nga Prezenca nuk çojnë domosdoshmërisht në rezultate të prekshme për popullsinë në përgjithësi, mënyra sipas së cilës kandidatët e ardhshëm për kryetarë bashkish dhe komunash mund t’u përgjigjen shqetësimeve të qytetarëve do të jetë e rëndësishme për të përcaktuar jo vetëm se sa të gatshme janë partitë për të tërhequr votues të pakënaqur dhe indiferentë, por edhe nivelin e pjesëmarrjes aktive qytetare në procesin qeverisës.

Reforma zgjedhore

Meqenëse reforma zgjedhore mbetet një nga çështjet më të rëndësishme politike në axhendën kombëtare gjatë muajve të kaluar, Prezenca ka vazhduar të lehtësojë në nivelin më të lartë fazat përfundimtare të punës së Komisionit Dypalësh për Zbatimin e Rekomandimeve të ODIHR-it. Afati për përfundimin e negociatave lidhur me ndryshimet në Kodin Zgjedhor ishte vendosur data 31 mars, me qëllim që ato të miratoheshin në kohë për zgjedhjet vendore të tetorit. Pas kapërcimit të mosmarrëveshjeve midis pozitës dhe opozitës në lidhje me një sërë çështjesh gjatë dy mandateve të para të komisionit, mandati i tretë dhe përfundimtar u përqendrua në hartimin e ndryshimeve. Kjo kërkoi punë intensive

⁵ Po aty.,viii

⁶ Raporti i FMN-së, 30

dhe diskutime në zyrat e Prezencës nga grupi kryesor negociator në fundjavë dhe pas mesnate.

Mosmarrëveshjet e thella të përmendura në raportin e mëparshëm të Prezencës për shkak të ndryshimeve në lidhje me mosndërhyrjen e shtetit dhe Qeverisë në procesin zgjedhor u zgjidhën pas vizitës së bashkë-kryetarëve në Këshillin e Përhershëm më 6 shkurt. Pas diskutimeve të tyre me delegacionet, bashkëkryetarët u kthyen në Shqipëri me një vendosmëri të re për të kryer detyrat e komisionit duke shmangur çdo bllokim të tyre në të ardhmen. Në mënyrë kuptimplote, të dy bashkëkryetarët përvetësuan deklaratat e bëra nga Kryesia e BE-së dhe Shteteve të Bashkuara dhe përsëritën publikisht kërkesat e Këshillit të Përhershëm për angazhim të plotë ndër-partiak për kompromis.

Deri në fund të muajit mars, të gjitha rekomandimet e përfshira në *Raportin Përfundimtar të ODIHR-it për Zgjedhjet e vitit 2001* që kishin lidhje me zgjedhjet për pushtetin vendor ishin trajtuar nga Komisioni Dypalësh. U miratuan gjithsej 16 paketa amendamentesh dhe rekomandimesh për veprim nga organe të tjera shtetërore si Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve (KQZ) për çështje që lidhen me rolin e policisë në procesin zgjedhor, rolin e vëzhguesve, regjistrimin e kandidatëve, mbulimin nga media, formatin e fletëve dhe kutive të votimit. Çështja shumë e rëndësishme e procesit të ankimimeve dhe apelimeve kërkoi zgjatjen e mandatit të komisionit me një javë.

Pas mbarimit të mandatit të komisionit, Prezenca vazhdoi të lehtësojë bisedimet midis Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike për arritjen e një marrëveshjeje lidhur me përbërjen dhe procedurat e përzgjedhjes së KQZ-së. Megjithëse kjo çështje del jashtë rekomandimeve të ODIHR-it, ajo përbente një shqetësim të qartë për palët, të cilat e konsideronin arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme si një letër lakmushi për suksesin ose dështimin e procesit. Kur fillimisht nuk u arrit të gjendej një marrëveshje përfundimtare lidhur me procedurën për caktimin e anëtarit të shtatë të KQZ-së, diskutimet e mëtejshme të zhvilluara nën kujdesin e Presidentit të Republikës e sollën këtë marrëveshje më afër. Megjithatë, u zhvilluan bisedime përfundimtare me ndërmjetësimin e Prezencës. Për të siguruar që Kuvendi të mund të miratonte paketën e amendamenteve të Komisionit Dypalësh me pëlqimin e të gjitha partive, dy marrëveshje të tjera protokolli u nënshkruan nga përfaqësuesit e PS-së dhe PD-së në praninë e Kryetarit të Prezencës më 12 dhe 17 maj për të zgjidhur mosmarrëveshjet e mbetura për çështje të tjera.

Me nënshkrimin e këtyre protokollëve, reforma zgjedhore mund të konsiderohet e përfunduar me sukses pas një viti negociatash. Prezenca luajti një rol të rëndësishëm në përkrahjen dhe lehtësimin e gjithë procesit dhe në nxitjen e qëndrimeve konsensuale dhe të kënaqshme për të gjithë drejt zgjidhjeve të realizueshme. Arritjet e Komisionit Dypalësh i takojnë, gjithashtu, në mënyrë të konsiderueshme angazhimit personal të dy bashkëkryetarëve, megjithatë, procesi do të kishte dështuar kohë më parë, po të mos ishte dëshira e qartë të dy partive kryesore politike për të arritur një përfundim të kënaqshëm. Kjo është shumë e rëndësishme, duke ditur se raporti i ODIHR-it evidentonte se vullneti i pamjaftueshëm politik nga ana e partive kishte penguar zgjedhjet e vitit 2001 në përmbushjen plotësisht të standarteve ndërkombëtare.

Me qëllim që të sigurojë sukses, maxhoranca bëri një sërë ofertash të guximshme, si lejimin e votimit 5:2 për një numër vendimesh të rëndësishme dhe një KQZ të “ekuilibruar” politikisht, duke treguar një nivel të lartë fleksibiliteti. Po ashtu, megjithëse opozita vazhdimisht kërkoi lëshime në favor të saj, ata qëndruan të hapur për dialog, në kontrast të thellë me procesin e hartimit të Kodit Zgjedhor në vitin 2000. Nga ky këndvështrim, procesi i Komisionit Dypalësh dëshmoi se ishte një instrument i fuqishëm për të nxitur një shkallë ndryshimi në marrëdhëniet ndërpartiake. Të gjitha vendimet u morën me mbështetjen e gjerë ndërpartiake, si dhe me konsensusin e kërkuar midis PS-së dhe PD-së. Për më tepër, klima e punës në Komisionin Dypalësh mbeti e pandikuar nga tensionet dhe retorikat në rritje rreth debateve mbi ngritjen e komisionit hetimor për Edi Ramën dhe çështje të tjera të diskutueshme.

Zgjedhjet për pushtetin vendor do të jenë një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të mëtejshëm demokratik të Shqipërisë, duke pasur parasysh rregullat e miratuara me konsensus, që do të rregullojnë procesin zgjedhor dhe që nuk lejojnë asnjë parti të ushtrojë ndikim të pavend, për sa kohë të ruhet vullneti politik që kërkohet. Masa në cilën partitë do të konkurrojnë për të fituar vota, duke paraqitur politika dhe jo duke u mbështetur në rezultate të arritura nëpërmjet shfrytëzimit të mekanizmave institucionalë, do të jetë një mjet për të treguar se sa ka përparuar ky zhvillim.

Megjithatë, para se të mendohet për këtë, ende kërkohet miratimi i ndryshimeve përfundimtare të Kodit Zgjedhor dhe zëvendësimi i tre anëtarëve të KQZ-së, mandati i të cilëve është lejuar të mbarojë në fund të prillit në kundërshtim me ligjin, me qëllim që të sigurohet përgatitja e duhur për zgjedhjet e kësaj vjeshte.

Në protokollin përfundimtar u ra dakort që debati mbi çështjet afatgjata të sistemit zgjedhor, kufijtë e zonave zgjedhore dhe financimin e fushatave do të fillojnë sapo të përfundojnë zgjedhjet vendore, pasi këto çështje nuk ndikojnë në zgjedhjet e ardhshme. Protokollin e njeh gjithashtu rolin e Prezencës dhe ODIHR-it në sigurimin e asistencës dhe ekspertizës. Prezenca parashikon se debati mbi këto çështje do të vazhdojë në vitin 2004, dhe se duhet të mbarojë para zgjedhjeve parlamentare të pranverës 2005.

Reforma e Legjislacionit për Pronat

Prezenca sinjalizoi për rëndësinë dhe urgjencën e zgjidhjes së çështjes së vjetër të kthimit dhe kompensimit të pronave, një çështje që Prezenca e ka inkurajuar që në nëntor 2001, në raportin e saj të mëparshëm në Këshillin e Përhershëm. Përveç kërkesës kushtetuese - afati i së cilës ka mbaruar jo shumë kohë përpara - për adoptimin e një ligji të ri për pronat, një tjetër nxitje është dhënë nga Komisioni Evropian gjatë negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit. Duke pasur parasysh natyrën shumë emocionale dhe përçarëse të të drejtave të pronësisë, Prezenca ka vazhduar të takohet me përfaqësues të politikës dhe Kuvendit gjatë muajve të fundit, të cilët e kanë ftuar Prezencën që të fillojë një proces politik për gjetjen e një zgjidhjeje të kënaqshme të problemit. Si hap i parë, Prezenca kontribuoi me komente të gjera mbi dy projekt-ligje që iu paraqitën Kuvendit nga deputetët e Qeverisë dhe të opozitës, duke nxjerrë në pah një numër çështjesh që kërkojnë rregullim të mëtejshëm në ligj.

Prezenca ofroi, gjithashtu, një numër sugjerimesh mbi organizimin e punës së Kuvendit, megjithëse, deri tani, nuk ka patur ndonjë përparim të dukshëm. Ndërsa Prezenca ka sugjeruar që projekt-ligji i paraqitur nga Qeveria të përdoret si pikë nisjeje dhe ka theksuar se jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i jep Qeverisë hapësirë të konsiderueshme për të arritur një zgjidhje brenda mundësive të saj, d.m.th. kthimi dhe/ose kompensimi i plotë nuk është një e drejtë absolute, ajo shprehu, gjithashtu, shqetësimin lidhur me gatishmërinë e përfaqshme të Qeverisë për të nxitur një kalim të shpejtë të projekt-ligjit të saj, duke paralajmëruar kështu një dorëheqje nga një preference e shprehur më parë për arritjen e një ligji të miratuar me konsensus. Prezenca ka bërë përpjekje, të cilat janë mbështetur nga Komisioni Evropian dhe Ambasada Amerikane në Tiranë, për të bindur Qeverinë që të mos veprojë në këtë mënyrë.

Megjithë mbështetjen e heshtur që Partia Demokratike i dha fillimisht projekt-ligjit të Qeverisë, presionet e fushatës zgjedhore dhe dëshira e saj për të nxitur një koalicion kompakt të forcave të opozitës e çuan atë të vihet në anën e partive më të vogla të opozitës që tradicionalisht kanë folur më hapur për këtë çështje. Shumë prej këtyre partive mbështesin shfuqizimin e ligjit të vitit 1991, që krijoi reformën e parë për pronësinë për tokat. Protestat e fundit të banorëve që jetojnë në periferitë e Tiranës dhe Durrësit, të cilët kryesisht kanë migruar nga zonat rurale veriore drejt zonave urbane, i kanë dhënë një tjetër dimension problemit tashmë kompleks, përmes kërkesave urgjente për legalizimin e pronave të tyre të ndërtruara në toka të zëna në mënyrë të kundraligjshme. Të dyja anët e debatit janë të gatshme t'i përdorin këto protesta për përfitime të mundshme zgjedhore për veten e tyre, që mund të sillte si pasojë kufizimin e mjeteve për arritjen e një zgjidhjeje të duhur ligjore afatgjatë, në qoftë se bëhen premtime të nxituara, pa pyetur për parimet e përgjithshme që kërkojnë një analizim të mëtejshëm.

Prezenca ka zhvilluar një plan pune për të lehtësuar debatet në komisionet parlamentare brenda afatit të propozuar në fund të muajit korrik. Komisioni Evropian dhe Ambasada Amerikane kanë shprehur mbështetjen e tyre për këtë plan pune. Para se të miratohet një ligj realist, kërkohet një analizë e hollësishme mbi sasinë dhe llojin e tokave të disponueshme për t'u kthyer dhe një llogaritje e kostos së mundshme të kompensimit. Meqënëse të dhënat e siguruara nga Qeveria mbi këto çështje u përcaktuan nga Kuvendi si jo të plota, është e nevojshme që të bëhen kërkime të tjera, të cilat do të mbështeten nga Prezenca.

Liria e Medias

Çështje që lidhen me lirinë e medias në Shqipëri janë bërë kohët e fundit subjekte të rëndësishme diskutimesh për gazetarët, pronarët e mediave dhe politikanët. Zgjedhjet vendore që po afrojnë i kanë dhënë këtij debati një tjetër kuptim dhe mund të jetë në të vërtetë shkaku kryesor që i vendos çështjet e medias në qendër të vëmendjes. Vëmendje i është kushtuar në veçanti mënyrave se si interesat e biznesit të medias ndërthuren me interesat e politikanëve, disa prej të cilëve janë edhe vetë pronarë mediash dhe shkallës së ndikimit të ushtruar në media me qëllim fitimin e avantazheve politike.

Tregu i pazhvilluar i radios dhe televizionit nuk garanton baza të shëndosha financiare për mbijetesën e një numri të ekzagjeruar operatorësh (afërsisht 60 stacione televizive për një

popullsi prej 3 milionësh), për të cilët burim kryesor të ardhurash janë ato që sigurohen nga reklamat.⁷ Duke qenë se shumicës së operatorëve u duhet të mbështeten në të ardhurat që sigurojnë nëpërmjet bizneseve të tjera për të mbështetur veprimtarinë e medias së tyre, kufizimet financiare i detyrojnë ata të kërkojnë ndihmë nga ligjvënësit në dëm të paanshmërisë së tyre. Për pasojë, interesat e politikanëve për akses në media çenojnë autoritetin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, organit rregullues shtetëror për transmetimin, duke i inkurajuar operatorët e mbrojtur politikisht që të mos i marrin parasysh standartet e vendosura me ligj. Duke qenë se rreth 60% e reklamave në media paguhet nga institucionet shtetërore⁸ ose të financuara nga buxheti i shtetit, reklamimi i sponsorizuar nga Qeveria është bërë mjeti më efikas për të ushtruar presion mbi median. Kjo situatë është theksuar në raporte të lëshuara nga Prezenca vjeshtë e kaluar dhe, së fundi, nga Departamenti Amerikan i Shtetit⁹ dhe Grupi Ndërkombëtar i Krizave¹⁰, të cilët vërejnë, gjithashtu, se bizneset private kanë gjithmonë e më shumë frikë se mos, duke u reklamuar nga media anti-qeveritare rrezikojnë të bëhen objekt i kontroleve financiare. Si rezultat, shumica e mediave janë bërë haptazi pro-qeveritare në raportimet e tyre.

Çështjes së lirisë së medias iu kushtua më shumë vëmendje në shkurt, kur gazetarët që po transmetonin debatin në një seancë plenare të Kuvendit mbi mocionin e opozitës për krijimin e një komisioni hetimor për Kryetarin e Bashkisë së Tiranës u lanë jashtë ndërtesës gjatë votimit përfundimtar, i cili u refuzua nga shumica. Gazetarë të njohur e denoncuan këtë akt si çensurë dhe si kundërshtim me rregulloren e brendshme të Kuvendit. Ngjarja shkaktoi një diskutim të gjerë publik mbi shkallën e influencimit të Qeverisë në media. Një numër në rritje rastesh akuzimi për shpifje ngritur nga politikanët kundër gazetarëve vetëm sa i ka rritur këto shqetësime.

Aktualisht, Prezenca është duke kërkuar rrugë dhe mënyra për të siguruar që media të jetë aktive dhe të luajë rolin që i takon gjatë afrimit të fushatës zgjedhore. Përfshirja e Prezencës në fushën e zhvillimit të medias gjatë vitit të kaluar ka qenë për të ndihmuar në forcimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), i cili mbetet një subjekt i dobët. Ndërsa KKRT-ja vazhdon të lejojë transmetuesit të operojnë jo në përputhje të plotë me ligjin, Prezenca po e nxit këtë subjekt që të zbatojë me përpikmëri ligjin. Për këtë qëllim, Prezenca po mbështet aktualisht planin e KKRT-së për të racionalizuar përdorimin e spektrit të transmetimit përmes planit të frekuencave dhe për të zbatuar kështu procedurat e licencimit. Përveç kësaj, Prezenca po angazhohet në çështje si e drejta e autorit dhe media e shkruar dhe do t'i sigurojë asistencë legislative Komisionit Parlamentar për Median mbi këto çështje.

Politika rajonale

Qeveria shqiptare ka vazhduar të ndjekë një politikë aktive bashkëpunimi rajonal që synon arritjen e një sërë marrëveshjesh shumëpalëshe për tregtinë e lirë mbarërajonale, lidhjen e

⁷ Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit. *Raporti Vjetor 2002*. Dorëzuar Kuvendit në prill 2003.

⁸ Diana Kalaja. "Nga Shqipëria: Gjendja e Medias në Shqipëri – Berlusconi e vegjël Kërcënojnë Lirinë e Mediave të Vërteta Shqipëtare." *Raportet Speciale Online për Median* (21 prill 2003).

⁹ Departamenti Amerikan i Shtetit, Zyra e Demokracisë, të Drejtave të Njeriut dhe Punës. *Raportet mbi Praktikën për të Drejtat e Njeriut të Vendeve të ndryshme për vitin 2002* (Washnigton, DC: 31 mars 2003).

¹⁰ Grupi Ndërkombëtar i Krizave. "Shqipëria: Shteti i Kombit 2003." *Raportet mbi Ballkanin* Nr.140 (Tiranë/Bruksel: 11 Mars 2003).

Shqipërisë me rrjet hekurudhor me Malin e Zi dhe ish-republikën Jugosllave të Maqedonisë, si dhe marrjen e iniciativave rajonale dhe dypalëshe për rritjen e përpjekjeve për të luftuar krimin e organizuar ndërkufitar. Takime të shpeshta të nivelit të lartë me liderët e Serbisë dhe Malit të Zi vazhdojnë ende të zhvillohen. Në mënyrë të veçantë, përpjekjet e Shqipërisë për të siguruar anëtarësimin e ardhshëm në NATO, së bashku me Kroacinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, çuan në nënshkrimin e Kartës së Adriatikut mes tre kombeve dhe Shteteve të Bashkuara në Tiranë më 2 maj, me rastin e vizitës së Sekretarit amerikan të Shtetit, Colin Powell. Kjo arritje e madhe figuron bashkë me hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian si njëra nga dy shtyllat e strategjisë shqiptare të integritit në strukturat Euro-Atlantike. Këto suksese, të shoqëruara me denoncimin e fortë të Qeverisë shqiptare të strategjive separatiste në rajon, që kërkojnë të shtypin tendencat radikale jashtë vendit, shërbejnë si faktorë stabilizimi të brendshëm dhe të jashtëm.

Në mbështetje të perspektivës rajonale dhe përpjekjeve të Shqipërisë për të luftuar krimin ndërkufitar, Prezenca vazhdon të lehtësojë Takime të Përbashkëta Ndërkufitare (TPNK) midis autoriteteve shqiptare dhe UNMIK-ut. Suksesi i përpjekjeve ka çuar në arrestimin e një numri kriminelësh të kërkuar në të dyja anët e kufirit dhe madje ka rritur iniciativat e pavarura lokale midis kryetarëve të komunave shqiptare dhe homologëve të tyre në anën e Kosovës/Serbisë dhe Malit të Zi, të cilët vijnë kryesisht nga grupe minoritetesh etnike që jetojnë në zonën e Dragashit. Versioni përfundimtar i dokumentit për të ardhmen i Konferencës së fundit Rajonale të Ohrit mbi Sigurimin dhe Menaxhimin e Kufijve i jep Prezencës një rol në asistimin e Qeverisë shqiptare për zbatimin e Planit të saj Strategjik për Menaxhimin e Kufirit, dhe në ndihmën për të formuluar një iniciativë të përbashkët brenda kushteve të Sistemit të BE-së për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe në shtrirjen e modelit të TPNK-së në segmente të tjera të kufirit shqiptar.

Përfundime

Pavarësisht nga përmirësimet kryesore në klimën politike dhe zhvillimin e arritur në reformën zgjedhore, fokusi aktual në çështjet që kanë lidhje me zgjedhjet e ardhshme e ka tërhequr vëmendjen nga fushat e tjera, përveç disa sukseseve të rëndësishme të arritura në politikën rajonale. Këto suksese tregojnë se si mund të arrihet një përparim konkret drejt një qëllimi afatgjatë nëpërmjet caktimit të përparësive nga Qeveria dhe mbështetjes ndërpartiake. Progresi i arritur në një sërë reformash që kanë lidhje me procesin e Stabilizim Asociimit nuk ka qënë i mjaftueshëm, siç theksohet edhe në raportin e Komisionit Evropian. Ato shtrihen kryesisht në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme dhe janë fokusuar edhe në raportet e mëparshme të Prezencës. Duket se Qeveria dhe Kuvendi kanë marrë hapa për t'i kapërcyer këto mangësi.

Pavarësisht nga një numër i madh programesh të mira, strategjish kombëtare dhe legjislationit të përparuar, zbatimi është ende jashtëzakonisht i ngadalshëm dhe përpjekjet për të ndryshuar realitetet e përditshme ekonomike dhe sociale ende nuk po prodhojnë një përparim të mjaftueshëm. Duke pasur parasysh rritjen e shpejtë të popullsisë dhe normën e lartë të inflacionit, ka një rrezik të mundshëm për trazira të reja shoqërore dhe politike.

Procesi konsensual ka ende nevojë të mbështetet, sepse çështjet e rëndësishme politike me të cilat po përballet vendi aktualisht kanë shkaktuar fërkime midis Qeverisë dhe opozitës. Në këtë kontekst, Prezenca ka luajtur një rol konstruktiv në reformimin e Kodit Zgjedhor dhe fillimin e procesit mbi reformën e legjislationit për pronat, të cilat janë që të dyja çështje politike kyçe. Në diskutimet për aktivitetet e vitit 2004, Prezenca po planifikon që të mbështesë ekspertizën e saj dhe lehtësimin për të siguruar vazhdimin e bisedimeve mbi çështjet që lidhen me sistemin zgjedhor dhe kufijtë e zonave, ashtu si dhe me zbatimin e një ligji përfundimtar për pronat. Përsa i përket çështjes së ndarjeve të reja administrativo-territoriale, ku Prezenca ka marrë tashmë një angazhim paraprak, ajo po përgatitet që të moderojë një proces jashtëzakonisht kërkues, i cili duhet të zhvillohet në një mënyrë sa më konsensuale që të jetë e mundur.